

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Siguracioni ndaj të tretëve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 66512100-3;
66516000-0; 66517300-0; 66519000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 14,470,000 (katërmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë)
lekë pa tvsh;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” , në nenin 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të

paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

**Polica e sigurimit është e barazvlefshme me faturën tatimore.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 40 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë lejen për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe në Vendimin Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajnohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta.

Me anë të këtij kriteri kërkojmë që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Shërbimi i sigurimit ndaj të tretëve nuk mund ta ofrohet nga çdo subjekt tregtar por vetëm nga ato subjekte të licensuara/autorizuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), ndaj duke qenë se është në proporcion me objektin e prokurimit të kësaj procedure vlerësojmë që operatorët ekonomikë ta disponojnë këtë dokument.

2.2.3 Operatori ekonomik (kompania e sigurimit) duhet të vetëdeklarojë se, është plotësisht e risiguruar me kompani të sigurimit ndërkombëtar me klasifikim të kreditit të paketës të paktën të barabartë me BBB + (S & P ose ekuivalent), dhe ku te paktën 50% e policës është e risiguruar me një kompani të sigurimit primar ndërkombëtar me klasifikim të kreditit të paktën të barabartë me A+ (S & P ose ekuivalent). Operatori ekonomik fitues, duhet të paraqesë para lidhjes së kontratës dokumentin që vërteton risigurimin si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në nenin 197 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” ku thuhet se: *sigurimi i përgjegjësishë profesionale dhe garancia financiare e agjentit/shoqërisë së agjentëve në sigurime 1. Agjenti/shoqëria e agjentëve në sigurime siguron në një shoqëri sigurimi përgjegjësishë profesionale të saj ndaj palëve të treta. 2. Shoqëria e agjentëve në sigurime detyrohet të ketë, në mënyrë të vazhdueshme, një garanci financiare në masën 4 për qind të shumës së primeve vjetore të mbledhura, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 500 000 lekë. Garancia financiare depozitohet në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të shoqërisë së sigurimit për të cilën vepron. 3. Autoriteti përcakton me rregullore shumën e mbulimit të policës së sigurimit të përgjegjësishë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.*

Shoqëritë e risigurimit me të cilat shoqëria e sigurimit që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë, lidh marrëveshje risigurimi, duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme : - Nuk duhet të jetë në proces falimentimi. - Lideri i marrëveshjes së risigurimit nuk mund të ketë klasifikimin BBB (ose më të ulët) nga Standart&Poor. - Risiguruesi i kontraktuar për shtresat e pa limituara në marrëveshjen e risigurimit, nuk mund të ketë klasifikimin më të ulët se BBB nga Standart&Poor. - Çdo risigurues, pjesë e kontratës së risigurimit i cili ka 10% ose me shumë, nuk mund të ketë klasifikimin më të ulët se BBB nga Standart & Poor. Vendosija e këtij kriteri bazohet gjithashtu edhe në Marrëveshjen e Mirëmbajtjes Midis TAP dhe AGSco, në klauzolën 3.1 pika (a. v) ku kërkohet që kompania të ketë sigurim për palët e treta përpara se të fillojnë operacionet. Kërkesat (kriteret teknike dhe kualifikuese) për këtë policë janë të theksuara në mënyrë taksative në përputhje me pikën 21 të kontratës, dhe skedulën 12. AGSco, rimburohet 100% për këtë shpenzim nga TAP me paraqitjen e kontratës së sigurimit. Në skedulë 12, kërkohet angazhimi i një siguruesi me reputacion për të dhënë shërbimin e kërkuar. Po në kontratë, në pikën 12 (pika 12.3), kur flitet për sigurimin e kontratës, kërkohet sigurim në një Agjenci të kuotuar me A- sipas “Standard and Pooors” (“bank or insurance company ëith a minimum rating of A- at Standard and Poor’s or A3 at Moody's”).

Ne tregun shqiptar nuk operon asnjë Agjenci sigurimesh e vlerësuar nga agjencite ndërkombëtare. Duke pasur parasysh llojin e policës, madhësinë e sasisë që do të sigurohet, është kërkuar që risigurimi të kryhet me kompani me vlerësim të lartë në përputhje me kërkesat e kontratës në pikën 12. Te gjitha kompanite në vend mund të risigurohen në tregun ndërkombëtar (e parashikon Ligji 52/2014), ajo që kërkojmë është të risigurohen në kompani me vlerësim të lartë referuar standarteve nderkombetare (shiko Standard & Poor's Ratings ne google per te pare kategorite). Për të pasur një diapason më të gjerë zgjedhje për të gjitha kompanitë, nuk është kërkuar detyrimisht një risigurues i vetëm por edhe një kombinim i mundshëm, për këtë arsye është kërkuar që të paktën 50% e paketës së risiguruar të jetë me një kompani të vlerësuar me A+ (paketa në tërësi duhet të jetë e një niveli mbi BBB+).

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara ne Kodin e Etikes te AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit te kesaj kontrate. (ky kod eshte i publikuar në SPE se bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektesisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut te lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose te tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara ne Kodin e Etikes të AGS SHA qe kane lidhje me realizimin e objektit te kesaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga nevojat e Autoritetit Kontraktor dhe detyrimet qe përcaktohen nga marrëveshja me TAP, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën e shërbimit dhe afatin kohor për realizimin e këtij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.